



Datë: 28.03.2025

Numër protokolli: 3031/2025

A.nr.236/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.236/2025, të datës 29.01.2025, të parashtruar nga ankuesi F.G., kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.236/2025, e datës 29.01.2025, e parashtruar nga ankuesi F.G. **Shfuqizohet** Vendimi me numër protokolli 3408, i datës 30.12.2024, i Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në procedurën disiplinore të kontestuar me ankesë, *çështja kthehet te rishqyrtim tek mbikëqyrësi i ankuesit*.

II. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit të IT-së në Inspektoratin e Punës që në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit dhe në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të rishqyrtoj çështjen disiplinore të ankuesit mbi bazën e pretendimeve për shkelje disiplinore të ngritura sikurse në kërkesën e datës 18.11.2024, duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra ne zbatim të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi F.G. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 29.01.2025 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së dispozitave të procedurës administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, ky i fundit, më datë 12.03.2024, ka përcjell provat materiale ndërlidhur më çështjen në procedurë të ankimit, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të LPPA-së, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 622/2025, të datës 29.01.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 19.12.2014 nga ankuesi për P.V, K.S dhe FD; Emailin për ftesë për seancë disiplinore datës 17.12.2024 për ankuesin; Vendimin me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës; Vendimin me numër protokolli 2524 të datës 01.10.2024; Emailin e datës 23.12.2024 nga P.V për ankuesin dhe F.D; Emailin e datës 22.10.2024 nga ankuesi për B.L; Emailin e datës 28.08.2024 nga ankuesi për N.H; Emailin e datës 21.08.2024 nga ankuesi për V.Zh; Emailin e datës 27.08.2024 nga ankuesi për N.H, L.J dhe D.H; Emailin e datës 23.08.2024 nga N.S për N.H; Emailin e datës 23.08.2024 nga V.Zh për N.S, B.L, LB. NH. F.I; Raporti nga konsulta mjekësore; Kopjen e ID-së të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 12.03.2025; Akt Emërimit e datës 06.03.2017; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 18.11.2024; Emailin e datës 04.10.2024 nga ankuesi për L.J; Raporti i prezencës në punës për ankuesin 01.01.2024 deri 13.11.2024; Listën me detaje të pushimeve vjetore; Procesverbalin e datës 20.12.2024 dhe 27.12.2024 të Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 12.03.2025 për shtyrje të afatit të vendosjes së ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, dhe së çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjti, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 57/2017 të datës 06.03.2017, është i punësuar në Inspektoratin e Punës dhe së i njëjti ushtron pozitën Menaxher i TI-së.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Logjistikë dhe IT-së më datë 18.11.2024 ka inicuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se nuk është paraqitur në punë më datë 04.10.2024, nga data 04.10.2024 deri më datë 06.10.2024 ka bërë vetëm hyrje me datë 07.10.2024, nga data 08.10.2024 deri më datë 22.10.2024 ka qenë në pushim mjekësor duke mos ofruar dëshmi mjekësore, dhe së nga data 04.11.2024 e deri me datë 18.11.2024 nuk është paraqitur në punë dhe nuk ka lajmëruar udhëheqësin e tij të drejtpërdrejt. Rrjedhimisht, më datë 06.12.2024, është bërë plotësimi i kërkesës për iniciim të procedurës disiplinore nga znj.D.H. si udhëheqëse e drejtpërdrejtë e ankuesit, ashtu që pretendohet së ankuesi nuk është paraqitur në punë prej datës 21.11.2024 e tutje.

Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më Vendimin me numër protokolli me numër 3408, të datës 30.12.2024 ka shpall përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore “*Braktisje e punës ose mungesa e paarsyeshëm*”, sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, pretendon se personi që ka inicuar procedurën disiplinore është emëruar ushtrues detyre nga një person që nuk ka kompetencë dhe nuk ka autorizim nga ligji për një gjë të tillë dhe këtë e ka konstatuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Komisioni Disiplinor ka vendosur në kundërshtim me normat ligjore, ngase kam qenë në pushim mjekësor dhe për këtë i kam njoftuar me email duke bashkëngjitur shkresat përkatëse. Kërkon që, ankesa të aprovohet si e bazuar të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë.

Kolegji i Këshillit përkitazi me pretendimin së personi që ka iniciuar procedurën disiplinore është emëruar ushtrues detyre nga një person që nuk ka kompetencë, si dhe mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në këtë procedurë disiplinore dhe si rrjedhojë e analizimit të provave materiale ka konstatuar së H.N. në cilësinë e Kryeinspektorit të Punës, më Vendimin me numër protokolli 2524, të datës 01.10.2024 ka caktuar Labinot Jasharin, në pozitën e Zyrtarit të Logjistikes dhe Pranimit, si ushtrues i detyrës së Udhëheqësit të IT-së dhe Shërbimeve Logjistike, në kohëzgjatje prej 6 muajve, kurse, sipas vendimit të kontestuar del së nga data 21.11.2024 si mbikëqyrës i ankuesit është D.H.(njësia përgjegjëse e organit të punësimit me rastin e përgjigjes në ankesë nuk ka ofruar vendim për emërimin e kësaj të fundit si Udhëheqësit të IT-së).

Në kuptim të kompetencës dhe autorizimit ligjor të z.N., për të vepruar si Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës, Kolegji i Këshillit në praktikën e konsoliduar të vendimmarrjes tashme ka qëndrim të qartë së z. H.N. nuk ka poseduar autorizim ligjor që të ndërmerr veprimet administrative të kontestuar nga pala ankuesi dhe që i referohen emërimit të ushtruesit të detyrës së pozitës së Udhëheqësit të IT-së sipas Vendimit me numër protokolli 2524, të datës 01.10.2024, atëherë, dhe si të tilla janë veprime të paligjshme-nule në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme i cili përcakton se: *1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;*

Andaj, nisur nga konstatimi si më lartë që inicimi i procedurës disiplinore konsiderohet si veprim nulë për shkaqet ligjore të sipër theksuara, atëherë, rrjedhë dhe çdo veprim tjetër pasues konsiderohet pa pasoja juridike, kështu që mbi këto rrethana, Kolegji erdhi në përfundimin që mos të trajtoj pretendimet e tjera ankimore lidhur veprimet e Komisionit Disiplinor.

Këshilli bazuar në autorizimeve ligjore sipas nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme dhe nenit 18 paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, aprovoj ankesën si të bazuar, shfuqizoj Vendimin me numër protokolli 3408, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës dhe çdo veprim tjetër administrativ të ndërmarr në procedurën disiplinore të kontestuar me ankesë, duke kthyer çështjen në rishqyrtim tek mbikëqyrësi i ankuesit-Udhëheqësi i Divizionit të IT-së në Inspektoratin e Punës me obligimin që ky i fundit të rishqyrtoj çështjen disiplinore të ankuesit mbi bazën e pretendimeve për shkelje disiplinore të ngritura sikurse në kërkesën e datës 18.11.2024. Rrjedhimisht, Mbikëqyrësi i ankuesit me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit duhet të marrë për bazë pikëpamjet juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi. Fillimisht duhet të konstatohet se shkelja disiplinore në kuadër të cilave shkelje hynë, duke marrë për bazë dispozitat e nenit 56 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe më pastaj të procedohet me tutje me veprimet procedurale, ashtu që nëse pas kualifikimit të shkeljeve të supozuara, konstatim bie që shkeljet e ankuesit janë të natyrës së lehtë disiplinore, masën mund t'ia shqiptoj udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, kurse, nëse shkeljet e ankuesit kualifikohen si shkelje të rënda, duhet të veprohet sipas dispozitave të ligjit material lidhur me hapjen e procedurës disiplinore pranë komisionit disiplinor të Inspektoratit të Punës, mirëpo, në çdo rrethanë, akti përmes së cilës konfirmon vullnetin e organit publik duhet të jetë në pajtim të plotë me parimet bazike të përcaktuara me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme.

Rrjedhimisht, në kontekst të çështjes Kolegji thekson faktin së braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4 nënpika 4.10 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe se procedura disiplinore fillon pa vonesë, me vënien në dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda afatit dy (2) vjeçar nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, afati është pesë (5) vjet, sikurse, parashihet me nenin 59 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.236/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.G.;
- Organit të punësimit: Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.